



Sipas kërkesës së N.P.L."Higjiena" të dt.14.04.2020 nr.02-2436, për të ndihmuar Kompaninë Higjiena për përmbushjen e punëve dhe angazhimeve të stërngarkuara si rezultat i pandemisë së COVID 19, me kërkesën e Kryetarit të Komunës të dt.15.04.2020 nr.01-8463, duke u mbështetur në nenin 40.2 germa (b) dhe (c) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, nenit 26 pika 2 dhe 3 të Statutit të Komunës së Deçanit, Kuvendi i Komunës së Deçanit me anë të mbledhjes së nënshkrimeve të antarëve të kuvendit me dt.16.04.2020, merr këtë:

V E N D I M

PËR NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE PËR N.P.L."HIGJIENA" PËR TË OPERUAR GJATË SITUATËS ME COVID 19

- I. Aprovohen mjetet financiare për N.P.L."Higjiena" të cilës I nevoiten për të operuar gjatë situatës së krijuar nga pandemia COVID 19, për përmbushjen e punëve dhe angazhimeve të stërngarkuara të pa parashikuara, si rezultat i gjendjes së krijuar nga COVID 19, **në shumën prej 50,000.00 € (pesëdhjetmijëeuro).**
- II. -Një pjesë e mjeteve nga shuma e përgjithshme prej 50.000,00 € do të shpenzohen për paga të punëtorëve që kanë punuar me orar shtesë si dhe për shum shpenzime tjera të cilat nuk kanë qenë të parapara në kushtet e funksionimit normal.
Ndërsa Ndërmarrja "Higjiena" obligohet që të liroj nga pagesa për dy muaj(Mars dhe Prill) të gjitha bizneset që operojnë në Komunën e Deçanit.
- III. Mjetet financiare, si në pikën I. të këtij vendimi ndahen nga linja buxhetore e Drejtorisë për Shërbime Publike, nga kodi 18015-Infrastruktura Rrugore Deçan, nga projekti me nr.49773"Ndërtimi I qendrës rinore dhe kompleksit rinor" në kategorinë e Investimeve kapitale. nga të Hyrat Vetanake. Mjetet do të derdhen në gjirollogarinë e N.P.L. Higjiena" Deçan, në NLB Banka, nr. Gjirollogarisë 1706020700000269, nr.biznesit 811299082.
- IV. Për ekzekutimin e këtij vendimi do të kujdesen: Zyra e Kryetarit, Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe Drejtoria për Shërbime Publike e Komunës së Deçanit.
- V. Vendimi hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryesuesi i Kuvendit, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në web faqen e Komunës.
- VI. Me vendim njoftohen: NPL"Higjiena"SH.A. Zyra e Kryetarit, Drejtoria për Buxhet dhe Financa, Drejtoria për Shërbime Publike dhe Arhivi i KK Deçan.

01.Nr.IV-1

Deçan, dt.16.04.2020

Stampa e Kuvendit të Komunës së Deçanit me datë 16.04.2020. Niveli i dokumentit është 8536. Niveli i dokumentit është 01. Niveli i dokumentit është 2204 20.



Kryesuesi i Kuvendit:
Ilir Shehaj